

data 24.03.2025

## TERMAT E REFERENCES

### “Kompani për Menaxhim të mediave sociale të OJQ Nevo Koncepti”

<b>Organizata</b>	<b>OJQ “NEVO KONCEPTI  </b>
<b>Objektiva</b>	<b>Menaxhimi më i mirë i rrjeteve sociale të Organizatës Nevo Koncepti dhe krijimi i platformave të reja të mediave sociale.</b>

#### 1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin “Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga Asambleja Komunale e Fëmijëve.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 2 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

#### 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve” është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulta të komunës së Prizrenit.

### 3. OBJEKTIVA

Kompani profesionale, e cila do te kontraktohet do ta realizoje rishikimin dhe dizajnimin e faqes së internetit të organizatës dhe menaxhimin më të mirë të rrjeteve sociale, web faqja e cila ka për qëllim informimin dhe qasjen më të lehtë nga publiku i cili do të njoftohet për aktivitetet të cilat i realizon organizata Nevo Koncepti, gjithashtu hapjen e llogarive te reja për të promovuar aktivitetet e projekteve ne kuader të organizatës.

OJQ Nevo Koncepti është duke kërkuar një kompani e cila menaxhon mediat sociale dhe krjimin e llogarive të reja si dhe do ta realizojë rishikimin e faqës së internetit të organizatës për të pasur qasje më të mirë për publikun.

### 4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj nga 31 Mars deri me 17 Prill 2025.

### 5. REZULTATET E PRITSHME

- Rishikimi i web faqës së internetit të Nevo Konceptit (përmirësimin e dizajnit, strukturës dhe përmbajtjes për të arritur objektivat e organizatës dhe për të ofruar një përvojë më të mirë për vizitorët.
- Qasja më e lehtë në web faqe të organizatës dhe publikimi i aktiviteteve të cilat i realizojnë projektet e OJQ Nevo Koncepti.
- Hapja e llogarive të reja për publikimin e aktiviteteve si: LinkedIn, Instagram, TikTok.

### PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen dukë përfshirë këto dokumente:

- Kuptimi i detyrës dhe nëndetyrave të saj;
- Metodologjia dhe qasja që do të përdoret;
- Propozimi financiar për çdo ditë pune duke përfshirë një ofertë në shumën pa TVSH (kompani) dhe shumën bruto (individuale) përpara çdo zbritjeje ligjore të vendit të origjinës;
- Curriculum Vitae (për individë);
- Certifikata e biznesit dhe referencat (për kompanitë).

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 28.03.2025 deri në ora 16:30** në [prokurimi@nevokoncepti.org](mailto:prokurimi@nevokoncepti.org)